

Thirrje publike për vullnetarë

- A jeni të interesuar të kontribuoni për ngritjen e nivelit të arsimit të vajzave të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian?
- A jeni të gatshëm të angazhoheni për zvogëlimin e braktisjes së shkollimit të këtyre vajzave ?
- A dëshironi të fitoni përvojë pune dhe njohuri për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian?

Atëherë Organizata “Zëri i Romëve, Ashkalinjve dhe Egjiptianëve” ju fton të bëheni pjesë dhe të angazhoheni në programin e vullnetarëve për arsim.

Pse punë vullnetare? Sepse çdo punë vullnetare është një referencë për punësim.

SITUATA NË ARSIM TEK KOMUNITETET ROM, ASHKALI DHE EGJIPTIAN

Romët, ashkalinjtë dhe egjiptianët janë prej komuniteteve më të marginalizuara në vendin tonë, në sfera të ndryshme të jetës duke përfshirë dhe fushën e arsimit në të gjitha nivelet. Margjinalizimi i komuniteteve ka ndodhur dhe ndodh për arsye të ndryshme ekonomike, sociale, etnike, duke u bazuar në të dhëna mbi gjendjen e arsimit në veçanti të vajzave të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, nevojitet një sensibilizimi i shoqërisë me qëllim që të përkrahim, fuqizojmë sa më shumë nxënësit nga radhët e komuniteteve.

Në këtë kuptim, Organizata “Zëri i Romëve, Ashkalive dhe Egjiptianëve” ju fton të bëheni pjesë e programit *“punë vullnetare për fushën e arsimit të mesëm të ulët dhe mesëm të lartë”*.

CILI ËSHTË QËLLIMI I PROGRAMIT?

Organizata “Zëri i Romëve, Ashkalinjve dhe Egjiptianëve” është duke kërkuar 40-të vullnetarë të cilët/at janë të interesuar për t’i ndihmuar nxënësit e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian me theks të veçantë vajzat në ngritjen profesionale gjatë rrugëtimit të tyre akademik.

Objektivat kryesore të programit janë:

- Orientimi në karrierë i nxënësve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian;
- Motivimi për vazhdimin e shkollimit, ndihmë në përballimin e sfidave që do të ballafaqohen gjatë rrugëtimit të tyre në procesin e arsimit;
- Parandalimi i braktisjes së shkollimit, ngritja e performancës së vijueshmërisë, etj.

Ne synojmë zhvillimin socio-ekonomik të nxënësve të këtyre komuniteteve duke iu ndihmuar që në të ardhëm ta shfrytëzojnë potencialin e tyre dhe të luajnë rol produktiv në zhvillimin e shoqërisë.



VOICE OF ROMA, ASHKALI
AND EGYPTIANS IN KOSOVO

Vullnetarët duhet të jenë nga komunat si: Prishtinë, Ferizaj, Shtime, Lipjan, Podujevë, Prizren, Suharekë, Gjakovë, Pejë, Klinë, Istog, Fushë Kosovë, Rahovec, Mitrovicë, Vushtrri, Graçanicë, Novobërdë, Kamenicë, Obiliq dhe Gjilan (për komunat Graçanicë, Novobërdë, Kamenicë dhe Gjilan vullnetarë duhet të njohin edhe gjuhën serbe).

Kohëzgjatja – 22 korrik 2022

Data e fillimit – 05 gusht 2022

KUSH MUND TË APLIKOJ?

- Të gjithë të interesuarit që kanë vullnet të mirë për të kontribuar për zhvillimin dhe ngritjen e vajzave/nxënësve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian;
- Të jenë persona të moshës madhore;
- Të kenë të përfunduar së paku shkollimin e mesëm dhe të jenë,
- Komunikues dhe bashkëveprues;

Ne inkurajojmë kandidatet vajza/gra nga të gjitha komunitetet të aplikojnë për punë vullnetare.

CIALT JANË PËRGJEGJËSITË E MIA?

- Vullnetarët do të takohen së paku 2 herë në muaj me 2–3 vajza/nxënës nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian;
- Vullnetarët do t'i nxisin vajzat/nxënësit e këtyre komuniteteve për të vazhduar rrugëtimin e tyre akademik;
- Vullnetarët do të jenë të hapur për të diskutuar tema të ndryshme sociale që i preokupojnë vajzat/nxënëset;
- Vullnetarët do të jenë të hapur të diskutojnë për problemet/vështërsit/diskriminimin/bullizmin që mund të përjetojnë nxënëset/vajzat në shkollë, rrugë, shoqëri, etj;
- Vullnetarët do të jenë të hapur të diskutojnë dhe pengesat mënyrën e mësim-nxënies, procesin e mësim-nxënies së njohurive të reja në shkollë;
- Vullnetarët do të jenë të gatshëm të jenë urë lidhëse në krijimin e shoqërisë së re apo angazhimin në aktivitete të lira rekreative, kulturore, edukative, sportive, etj, konformë moshës së nxënësve/vajzave.

PSE TË APLIKOJ?

“Vullnetarët nuk paguhen, jo sepse nuk kanë vlerë, por sepse nuk ka çmim që paguan për kontributin e tyre” dhe çdo punë vullnetare është një referencë për punësim.



VOICE OF ROMA, ASHKALI
AND EGYPTIANS IN KOSOVO

- Ju do të kontribuoni në ngritjen e përfshirjes në arsimin e mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë të vajzave/nxënësve nga radhët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian;
- Ju do të kontribuoni në ngritjen e suksesit të mësim- nxënies së vajzave/nxënësve të komuniteteve në fjalë;
- Ju do të kontribuoni në ndërtimin e aftësive sociale të vajzave/nxënësve e këtyre grupeve etnike;
- Ju do të kontribuoni në parandalimin e braktisjes së shkollimit të vajzave/nxënësve të komuniteteve që janë në rrezik për braktisje;
- Ju do të kontribuoni në rritjen e numrit të nxënësve që përfundojnë arsimin fillorë, të mesëm dhe universitar nga radhët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian;

SI MUND TË APLIKOJ?

Të gjithë kandidatët e interesuar duhet të dërgojnë CV në email adresën: info@vora.org.

KUR ËSHTË DATA E FUNDIT PËR APLIKIM?

Afati i fundit për aplikim është: 05.08.2022. Pas përfundimit të afatit të aplikimit, të gjithë kandidatët që kanë aplikuar do të intervistohen dhe pas procedurës së përzgjedhjes dhe renditjes, kandidatët më të suksesshëm do të ftohen të fillojnë angazhimin e tyre si vullnetarë. Kohëzgjatja do të jetë 1 vit shkollor me mundësi vazhdimi.

UNË KAM PYETJE, ÇFARË TË BËJË?

Ju lutemi na kontaktoni në këtë email: b.ilazi@vora.org apo në numrin e telefonit: +383 (0)49 935 568

Ju mirëpresim!